

URDHËR
Nr. 169, datë 27.4.2022

**PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE TË HOLLËSISHME PËR KRITERET,
PROCEDURAT PËR PËRZGJEDHJEN E PËRFAQËSUESVE DHE FUNKSIONIMIN
E KOMISIONEVE DISIPLINORE, PËR MËNYRËN E USHTRIMIT TË
PËRGJEGJËSIVE PREJ TYRE DHE PËR ZHVILLIMIN E PROCEDIMIT
DISIPLINOR**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 e Kushtetutës, të nenit 7, pika 2, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe të nenit 35, pika 5, të ligjit nr. 82/2021, “Për përkthimin zyrtar dhe profesionin e përkthyesit zyrtar”,

URDHËROJ:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Ky urdhër ka për qëllim përcaktimin e rregullave më të hollësishme për kriteret, procedurat për përzgjedhjen e përfaqësuesve dhe funksionimin e Komisionit Disiplinor të Përkthyesve Zyrtarë dhe Komisionit Disiplinor të Interpretëve të Gjuhës së Shenjave, për mënyrën e ushtrimit të përgjegjësive prej tyre dhe për zhvillimin e procedimit disiplinor.

Neni 2
Përkufizime

Në këtë urdhër termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

- a) “Komision disiplinor” është Komisioni Disiplinor i Përkthyesve Zyrtarë ose Komisioni Disiplinor i Interpretëve të Gjuhës së Shenjave që shqyrtojnë kërkesat e ministrit të Drejtësisë për procedim disiplinor ndaj përkthyesve zyrtarë dhe interpretëve të gjuhës së shenjave;
- b) “Hetime” janë tërësia e veprimeve procedurale administrative, që ndërmerren nga Komisioni Disiplinor për të sqaruar një çështje të veçantë;
- c) “Provë” është çdo e dhënë, dëshmi, dokument apo fakt, që shërben në nxjerrjen e konkluzioneve të hetimit dhe që merret sipas dispozitave ligjore dhe kësaj rregulloreje;
- ç) “Dëshmitar” është personi i thirrur nga komisionet disiplinore për të dëshmuar mbi ngjarjet dhe faktet vetëm dhe për shkak të lidhjes me çështjen objekt shqyrtimi;
- d) “Ekspertë” janë persona, që për shkak të njohurive të posaçme në fushat e shkencës, teknikës apo në fusha të tjera specifike, thirren nga komisionet disiplinore, kur e konsiderojnë të përshtatshme;
- dh) “Vendim jopërfundimtar” është vendimi i komisioneve disiplinor, i marrë në çdo fazë të procedimit disiplinor për zhvillimin normal të veprimtarisë dhe të procedurave të mëtejshme të hetimit, të pyetjes së dëshmitarëve, shtyrjes së seancës, angazhimit të ekspertëve dhe përcaktimin e detyrave të tyre, pranueshmërinë e provave, si dhe për çdo çështje tjetër që komisionet disiplinore e vlerësojnë të nevojshme ose të përshtatshme në trajtimin e çështjes;

e) “Vendim përfundimtar” është vendimi që merret nga komisioneve disiplinore, për pranimin e kërkesës për procedim disiplinor dhe marrjen e një ose më shumë masave disiplinore ose rrëzimin e kërkesës.

Neni 3

Parimet e përgjithshme

Në ushtrimin e funksioneve të parashikuar në ligj dhe në këtë urdhër, komisionet disiplinore udhëhiqen dhe synojnë zbatimin e përshtatshëm dhe në mënyrë të balancuar të parimit, të:

- a) transparencës;
- b) procesit të rregullt ligjor, që garanton të drejtën për t’u informuar, për të kërkuar sqarime rreth fakteve, për t’u dëgjuar e për t’u mbrojtur;
- c) ligjshmërisë dhe barazisë para ligjit;
- ç) proporcionalitet në përcaktimin e masës disiplinore;
- d) prezumimin e pafajësisë;
- dh) dyshimit në favor të subjektit të procedimit disiplinor;
- e) pavarësisë dhe paanësisë;
- ë) konfidencialitetit dhe të së drejtës për jetë private dhe mbrojtjen e të dhënave personale.

KREU II

KRITERET DHE PROCEDURAT PËR PËRZGJEDHJEN E ANËTARËVE

Neni 4

Kriteret e përgjithshme për përzgjedhjen e përfaqësuesve

Përfaqësuesi në komisione disiplinore, duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme të mëposhtme:

- a) të jetë shtetas shqiptar;
- b) të zotërojë një diplomë të ciklit të dytë, të lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë të licencuara dhe të akredituara sipas dispozitave në fuqi në kohën e lëshimit të diplomës, ose të zotërojë një diplomë të të njëjtit cikël, të lëshuar nga një institucion i huaj i arsimit të lartë, të njohur e të njësuar pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin;
- c) të mos jetë i dënuar më parë për kryerjen e një vepre penale;
- ç) të mos jetë shkarkuar nga ushtrimi i detyrës, funksionit publik ose nga puna në pozicione të tjera pranë personave juridikë privatë për arsye të integritetit etik, me vendim të organit kompetent, që ka marrë formë të prerë, me përjashtim të rasteve kur kjo masë disiplinore është shuar dhe të mos ketë masë disiplinore në fuqi në çastin e paraqitjes së shprehjes së interesit;
- d) të mos jetë përkthyes zyrtar ose interpret i gjuhës së shenjave shqipe.

Neni 5

Kriteret e posaçme për përzgjedhjen e përfaqësuesve

1. Përfaqësuesi në Komisionin Disiplinor të Përkthyesve Zyrtarë, duhet të plotësojë kriteret e veçanta të mëposhtme:

- a) për përfaqësuesit nga ministria e Drejtësisë dhe ministria përgjegjëse për arsimin:
 - i. të jetë nëpunës civil i nivelit të mesëm ose të lartë drejtues;
 - ii. të ketë përfunduar studimet e integruara në drejtësi ose në një program të ciklit të dytë të studimeve universitare në drejtësi, të barasvlershëm me to, ose të ketë kryer studimet universitare në

drejtësi jashtë Shqipërisë dhe ka marrë një diplomë të barasvlershme, e njësuar sipas rregullave për njësimin e diplomave të parashikuar me ligj;

iii. të ketë jo më pak se 10 vjet përvojë profesionale si jurist;

iv. përfaqësuesit që njohin një nga gjuhët të cilat përfshihen në shërbimin e përkthimit zyrtar kanë përparësi;

b) për përfaqësuesin nga institucionet publike të arsimit të lartë, që ofrojnë programe studimi në gjuhë të huaja:

i. të jetë pjesë e personelit akademik të institucioneve të arsimit të lartë, i angazhuar me kohë të plotë, i kategorisë lektor ose profesor;

ii. të ketë jo më pak se 10 vjet përvojë profesionale në mësimdhënie në një nga gjuhët të cilat përfshihen në shërbimin e përkthimit zyrtar apo që lidhet me fushën e përkthimit.

2. Përfaqësuesi në Komisionin Disiplinor të Interpretëve të Gjuhës së Shenjave, duhet të plotësojë kriteret e veçanta të mëposhtme:

a) për përfaqësuesit nga ministria e Drejtësisë dhe nga ministria përgjegjëse për mbrojtjen sociale:

i. të jetë nëpunës civil i nivelit të mesëm ose të lartë drejtues;

ii. të ketë përfunduar studimet e integruara në drejtësi ose në një program të ciklit të dytë të studimeve universitare në drejtësi, të barasvlershëm me to, ose të ketë kryer studimet universitare në drejtësi jashtë Shqipërisë dhe ka marrë një diplomë të barasvlershme, e njësuar sipas rregullave për njësimin e diplomave të parashikuar me ligj;

iii. të ketë jo më pak se 10 vjet përvojë profesionale si jurist;

iv. përfaqësuesit që njohin gjuhën e shenjave kanë përparësi;

b) për përfaqësuesin nga radhët e interpretëve të gjuhës së shenjave shqipe ose nga trajnerët e certifikuar të programit të interpretëve të gjuhës së shenjave shqipe:

i. të ketë jo më pak se 10 vjet përvojë profesionale në interpretimin e gjuhës së shenjave shqipe, ose;

ii. të ketë jo më pak se 10 vite përvojë profesionale si trajnues i certifikuar i programit të interpretëve të gjuhës së shenjave shqipe.

3. Përfaqësuesit nga radhët e ministrive nuk mund të jenë njëkohësisht anëtarë të dy komisioneve disiplinore.

Neni 6

Publikimi i thirrjes për paraqitjen e shprehjeve të interesit

1. Pas miratimit të fillimit të procedurave të përzgjedhjes së komisioneve disiplinore nga ministri i Drejtësisë, thirrja për paraqitjen e shprehjeve të interesit për anëtarë të komisioneve disiplinore publikohet nga Ministria e Drejtësisë në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare dhe në faqen zyrtare të internetit të Ministrisë së Drejtësisë, ministrisë përgjegjëse për arsimin dhe ministrisë përgjegjëse për mbrojtjen sociale.

2. Thirrja qëndron e hapur për 14 ditë nga data e publikimit.

Neni 7

Afati për paraqitjen e shprehjes së interesit

1. Kandidati për anëtar të komisioneve disiplinore paraqet pranë Ministrisë së Drejtësisë shprehjen e interesit dhe dokumentacionin shoqërues brenda 14 ditëve nga përfundimi i afatit të përcaktuar në pikën 2, të nenit 6, të këtij urdhri.

2. Shprehja e interesit përmban këto të dhëna:

a) emrin, mbiemrin, atësinë, datëlindjen, vendlindjen, numrin personal të identifikimit;

b) adresën e vendbanimit dhe adresën elektronike, si dhe numrin telefonik të kontaktit të kandidatit;

c) përcaktimin se për cilët nga komisionet disiplinore kandidon për të qenë anëtar.

Neni 8

Dokumentacioni shoqërues

1. Kandidati për anëtar të komisioneve disiplinore, për të provuar përmbushjen e kriterëve të përgjithshme, paraqet dokumentacionin shoqërues si vijon:

a) kopje të mjetit të identifikimit;

b) jetëshkrimin;

c) kopje të njehsuar me origjinalin të diplomës së ciklit të dytë, të lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë të licencuara dhe të akredituara sipas dispozitave në fuqi në kohën e lëshimit të diplomës, ose diplomën e të njëjtit cikël, të lëshuar nga një institucion i huaj i arsimit të lartë, të njohur e të njehsuar pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin;

ç) vërtetim nga institucionet dhe personat juridikë privatë ku ka ushtruar detyrën ose funksionin publik apo me të cilat ka lidhur marrëdhënien e punës se ndaj tij nuk është dhënë masa disiplinore e shkarkimit për arsye të integritetit etik, me vendim të organit kompetent, ose nëse është dhënë kjo masë, vërtetim që kjo masë disiplinore është shuar, sipas legjislacionit në fuqi;

d) kopje të njehsuar me origjinalin të librezës së punës;

dh) vërtetim nga institucioni ku punon kandidati;

e) formularin e vetëdeklarimit të gjendjes gjyqësore të plotësuar dhe nënshkruar.

3. Kandidati për anëtar të komisioneve disiplinore, për të provuar përmbushjen e kriterëve të posaçme, paraqet dokumentacionin shoqërues si vijon:

a) përfaqësuesi nga ministra e Drejtësisë, ministria përgjegjëse për arsimin dhe ministria përgjegjëse për mbrojtjen sociale paraqesin vërtetime nga ministria përkatëse mbi pozicionin e punës;

b) përfaqësuesi nga institucionet publike të arsimit të lartë, që ofrojnë programe studimi në gjuhë të huaja paraqesin vërtetim nga institucione të arsimit të lartë që vërtetojnë se kandidati është pjesë e personelit akademik, i angazhuar me kohë të plotë, i kategorisë lektor ose profesor, si dhe çdo dokumentacion shtesë që vërteton se ka 10 vjet përvojë profesionale në mësimdhënie në një nga gjuhët të cilat përfshihen në shërbimin e përkthimit zyrtar apo që lidhet me fushën e përkthimit;

c) përfaqësuesit nga radhët e interpreteve paraqesin:

i. certifikatën e interpretit ose vërtetime apo çdo dokumentacion tjetër që provon se kandidati është trajnues i certifikuar i programit të interpreteve të gjuhës së shenjave shqipe;

ii. vërtetime dhe çdo dokumentacion tjetër që provon se kandidati ka jo më pak se 10 (dhjetë) vjet përvojë profesionale si interpret ose trajnues i certifikuar i programit të interpreteve të gjuhës së shenjave shqipe.

Neni 9

Verifikimi paraprak

1. Struktura përgjegjëse pranë Ministrisë së Drejtësisë administron shprehjet e interesit dhe dokumentacionin shoqërues të kandidatit për anëtar të komisioneve disiplinore dhe brenda 5 (pesë) ditëve nga përfundimi i afatit për paraqitjen e tyre, kryen veprimet e mëposhtme:

a) kur shprehja e interesit dhe dokumentacioni shoqërues janë përcjellë brenda afatit dhe sipas kërkesave të parashikuara në këtë urdhër, njofton kandidatin mbi vazhdimin e procedurës së verifikimit të kriterëve;

b) kur shprehja e interesit dhe dokumentacioni shoqërues nuk janë përcjellë brenda afatit dhe/ose sipas kërkesave të parashikuara në këtë urdhër, njofton kandidatin për plotësimin e të metave brenda 10 (dhjetë) ditëve nga marrja e njoftimit.

2. Në çdo rast struktura përgjegjëse i njofton kandidatit numrin unik të identifikimit i cili do të përdoret për qëllime të publikimit të listave të kandidatëve të kualifikuar dhe të skualifikuar.

Neni 10

Verifikimi i kritereve

1. Brenda 10 (dhjetë) ditëve nga njoftimi mbi vazhdimin e procedurës së verifikimit ose përfundimit të afatit për plotësimin e të metave, struktura përgjegjëse verifikon nëse kandidatët plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të parashikuara në këtë urdhër, në përputhje me parimet dhe rregullat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative.

2. Nëse dokumentacioni i paraqitur nuk vërteton plotësisht përmbushjen e kritereve, nuk është i plotë, i saktë ose ka dyshime të arsyeshme për vërtetësinë e tij, struktura përgjegjëse pranë Ministrisë së Drejtësisë mund të kërkojë informacion ose dokumentacion shtesë nga çdo organ publik apo persona të tjerë juridikë, vendas ose të huaj.

3. Për verifikimin e kriterit të mos qenies i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë, struktura përgjegjëse pranë Ministrisë së Drejtësisë kryen vetë kontrollin në sistemin elektronik përkatës ose, kur është e nevojshme, i kërkon Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve informacionin mbi dënimin ose jo të kandidatit. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dërgon informacionin brenda 3 ditëve nga marrja e kërkesës.

4. Në përfundim verifikimit mbi plotësimin kritereve ligjore, struktura përgjegjëse pranë Ministrisë së Drejtësisë harton dhe përcjell për miratim te ministri i Drejtësisë relacionin shpjegues për secilin kandidat ku pasqyrohen të dhënat e dokumentacionit të paraqitur dhe arsyet mbi propozimin për pranimin ose refuzimin e shprehjes së interesit, si dhe njoftimin përkatës mbi rezultatet e verifikimit të kritereve.

5. Struktura përgjegjëse mban parasysh që kandidatët e përzgjedhur të kenë njohuri nga gjuhë të ndryshme sipas listës së miratuar nga ministri i Drejtësisë.

Neni 11

Anëtarët zëvendësues

1. Për çdo përfaqësues të komisioneve disiplinore nga radhët e ministrive, nga institucionet e arsimit të lartë publik dhe nga radhët e interpretëve zgjidhet edhe një anëtar zëvendësues sipas të njëjtave kriteret dhe të njëjtës procedurës të përcaktuar për kandidatët për anëtarë të komisioneve.

2. Anëtari zëvendësues, zëvendëson anëtarin e zgjedhur në rastet e mungesave, të pamundësisë apo të paaftësisë fizike për të vepruar ose për shkak të një pengese për marrjen pjesë në procedimin disiplinor.

Neni 12

Publikimi i listës paraprake

Lista paraprake me numrin unik të identifikimit të kandidatëve të kualifikuar për të qenë anëtarë të komisioneve disiplinore dhe të kandidatëve të skualifikuar publikohet në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë. Kandidatët e skualifikuar njoftohen me shkrim, individualisht dhe në mënyrë të arsyetuar për shkaqet e përjashtimit.

Neni 13

Ankimi ndaj skualifikimit të kandidatit për anëtar të komisioneve disiplinore

1. Kandidatët e skualifikuar kanë të drejtë të ankohen pranë ministrit të Drejtësisë, brenda 5 (pesë) ditëve nga data e njoftimit, duke bashkëlidhur argumentet dhe dokumentacionin që provon përmbushjen e kritereve.

2. Grupi i punës i ngritur me urdhër të Ministrisë së Drejtësisë shqyrton ankimin e paraqitur dhe i propozon ministrit të Drejtësisë përfshirjen në listën e kandidatëve të kualifikuar, në rastet kur provohet përmbushja e kritereve kualifikuar për të qenë anëtarë të komisioneve disiplinore ose skualifikimin përfundimtar të tij. Ministri i Drejtësisë nxjerr urdhrin përkatës jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e paraqitjes së ankimit.

3. Struktura përgjegjëse përgatit edhe urdhrin e ministrit për skualifikimin e çdo kandidati, të renditur në listën paraprake të kandidatëve të skualifikuar dhe që nuk kanë paraqitur një ankim.

4. Urdhri i ministrit për skualifikimin e çdo kandidati i njoftohet kandidatëve të skualifikuar, në përputhje me rregullat e përcaktuara në Kodin e Procedurave Administrative.

Neni 14

Publikimi i listës përfundimtare

Lista përfundimtare me numrin unik të identifikimit të kandidatëve të zgjedhur si anëtarë të komisioneve disiplinore, si dhe të kandidatëve të zgjedhur si anëtarë zëvendësues publikohet në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë.

KREU III

FUNKSIONIMI DHE MËNYRA E USHTRIMIT TË PËRGJEGJËSIVE

Neni 15

Mënyra e organizimit të komisionit disiplinor

1. Kryetari dhe anëtarët e komisionit disiplinor zgjidhen për një mandat katërvjeçar me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë.

2. Mbledhja e komisionit disiplinor është e vlefshme kur janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve të tij dhe drejtohet nga kryetari.

3. Kryetari i komisionit disiplinor është një nga përfaqësuesit e zgjedhur nga ministri i Drejtësisë. Në mungesë të kryetarit, detyrat e kryetarit ushtrohen nga anëtari tjetër i zgjedhur nga ministri i Drejtësisë.

4. Shpenzimet për mbulimin e kostove administrative të punës së komisioneve disiplinore përballohen nga Ministria e Drejtësisë.

Neni 16

Heqja dorë ose përjashtimi i anëtarit

1. Anëtari i komisionit disiplinor i cili është në dijeni të një konflikti interesi ose të një pengese ligjore të parashikuara në nenin 30, të Kodit të Procedurave Administrative, për veten ose për një anëtar tjetër, është i detyruar të njoftojë menjëherë anëtarët e tjerë për natyrën e interesit ose pengesës dhe ka të drejtë të kërkojë heqjen dorë nga shqyrtimi i procedimit disiplinor.

2. Ministri i Drejtësisë, anëtari i komisionit disiplinor ose përkthyesi zyrtar apo interpreti i gjuhës së shenjave shqipe ndaj të cilit po ushtrohet procedimi, mund të kërkojë përjashtimin e një anëtari

nga procedimi disiplinor, deri në kohën e marrjes së vendimit, duke parashtruar arsyet për të cilat kërkohet përjashtimi. Kërkesa bëhet me shkrim, i drejtohet kryetarit dhe anëtarëve të tjerë dhe përmban të gjitha provat e mundshme në të cilat ajo mbështetet. Anëtari për të cilin pretendohet konflikti i interesit ose pengesa ligjore deklaron qëndrimin e tij në lidhje me këtë pretendim.

3. Në çdo rast, deri në shqyrtimin e kërkesës për përjashtimin e anëtarit pezullohet shqyrtimi i procedimit disiplinor.

4. Komisioni disiplinor merr vendim për pranimin e kërkesës për përjashtim apo për heqjen dorë ose rrëzon kërkesën, brenda 3 ditëve nga marrja e saj. Anëtari i Komisionit Disiplinor, ndaj të cilit është paraqitur kërkesa, nuk merr pjesë në shqyrtimin e kërkesës për përjashtimin e tij.

5. Kur komisioni disiplinor vendos për përjashtimin e anëtarit ose pranon kërkesën për heqje dorë, në procedimin disiplinor merr pjesë anëtari zëvendësues, që në përfundim të procedurës së përzgjedhjes së anëtarëve të komisionit disiplinor, është renditur menjëherë pas anëtarëve fitues në listë. Në rast se ky kandidat nuk pranon për t'u caktuar si anëtar zëvendësues, caktohet kandidati i renditur menjëherë pas tij.

6. Në rastet e pamundësisë së zëvendësimit, komisioni disiplinor funksionon si i tillë pa pjesëmarrjen e anëtarit të përjashtuar.

Neni 17

Kompetencat funksionale të komisionit disiplinor

1. Komisioni disiplinor heton, shqyrton dhe vendos mbi të gjitha rastet që lidhen me procedimet disiplinore ndaj përkthyesve zyrtarë ose interpretëve të gjuhës së shenjave shqipe, pas paraqitjes së raportit të hetimit së bashku me dosjen hetimore përkatëse nga ministri i Drejtësisë.

2. Komisioni disiplinor kryen të gjitha veprimet e nevojshme hetimore, me qëllim realizimin e një hetimi të plotë dhe të gjithanshëm administrativ, në përputhje me normat e Kodit të Procedurave Administrative dhe legjislacionit në fuqi për përkthimin zyrtar.

3. Komisioni disiplinor e ushtron veprimtarinë e tij në mënyrë kolegjiale, sipas rregullave dhe procedurave të parashikuara në legjislacionin për organizimin dhe funksionimin e organeve kolegjiale, me përjashtim të rasteve kur është parashikuar ndryshe në këtë urdhër.

Neni 18

Detyrat e kryetarit dhe anëtarit

1. Kryetari i Komisionit kryen këto detyra:

a) administron raportin e hetimit së bashku me dosjen hetimore, të paraqitur nga ministri i Drejtësisë për procedimin disiplinor ndaj përkthyesit;

b) informon anëtarët e tjerë të komisionit dhe përkthyesin zyrtar apo interpretin e gjuhës së shenjave subjekt të procedimit, mbi kërkesën e ministrit të Drejtësisë për procedimin disiplinor;

c) cakton dhe njofton kohën dhe vendin e seancës dhe merr konfirmimin me shkresë ose mjete elektronike të anëtarëve të komisionit disiplinor, palëve, si dhe personave të tjerë të interesuar, të cilët do të jenë pjesëmarrës në seancë.

ç) cakton dhe njofton rendin e ditës së mbledhjes, si dhe cakton relatorin e çështjes, referuar dosjes hetimore përkatëse për procedim disiplinor të paraqitur nga ministri i Drejtësisë, bazuar në parimet e transparencës, objektivitetit dhe në shpërndarjen rastësore dhe të barabartë të ngarkesës së punës midis anëtarëve;

d) informon anëtarët e komisionit në lidhje me detyrimin për t'u shprehur brenda 2 (dy) ditësh nga momenti i marrjes së njoftimit, nëse kanë konflikt interesi apo dyshime mbi paanësinë e tyre në

vendimmarrje, si dhe përkthyesin zyrtar apo interpretin e gjuhës së shenjave, subjekt të procedimit disiplinor nëse ka konflikt interesi me një prej anëtarëve të komisionit Disiplinor;

dh) së bashku me anëtarët e tjerë, merr vendim për pranimin e kërkesës për heqjen dorë ose përjashtimin e anëtarit të komisionit disiplinor, kur ka konflikt interesi apo ka dyshime në lidhje me paanësinë e tyre në vendimmarrje;

e) hap, mbyll dhe drejton mbledhjen duke siguruar mbarëvajtjen e saj në përputhje me kërkesat e këtij urdhri;

ë) pyet palët nëse kanë kërkesa paraprake nga palët të cilat vlerësohen nga komisioni disiplinor me vendim jopërfundimtar;

f) shtyn apo mbyll para kohe mbledhjet, në mënyrë të përligjur, duke e arsyetuar me vendim të pasqyruar në procesverbalin përkatës;

g) nënshkruan të gjitha aktet e nxjerra nga Komisioni;

gj) administron materialet e nevojshme, të cilat kërkohen nga anëtarët e tjerë;

h) kryen ballafaqimet dhe saktësimet e kërkuara nga anëtarët e tjerë, si dhe njofton mbylljen e diskutimeve;

i) thërret dëshmitarë nëse ka, për dëshmi shtesë apo ekspertët nëse janë të angazhuar nga komisioni;

j) u jep fjalën anëtarëve të tjerë të komisionit ose personave të tjerë të interesuar, nëse ata e kërkojnë, për të paraqitur pretendimet dhe sqarimet e tyre;

k) siguron zbatimin e ligjit procedural dhe material të zbatueshëm për organet kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike dhe marrjen e vendimeve të drejta;

l) çdo detyrë tjetër sipas këtij urdhri.

2. Anëtari i komisionit disiplinor kryen të paktën këto detyra:

a) njofton, me shkrim ose në rrugë elektronike, kryetarin mbi pjesëmarrjen në mbledhjen e komisionit disiplinor;

b) merr pjesë në mbledhje dhe respekton dispozitat e këtij urdhri;

c) ruan të dhënat me të cilat është njohur gjatë kryerjes së veprimtarisë së tij, duke respektuar parimin e konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale sipas legjislacionit në fuqi;

ç) paraqet kërkesën për heqje dorë nga shqyrtimi i procedimit disiplinor në rast konflikti interesi ose të një pengese ligjore;

d) voton për vendimet që merr komisioni disiplinor, me përjashtim të rastit kur është pranuar kërkesa për heqje dorë ose për përjashtim;

dh) çdo detyrë tjetër sipas këtij urdhri ose që i caktohet nga kryetari.

3. Relatori i çështjes kryen të paktën këto detyra:

a) përgatit raportin paraprak mbi çështjen për shqyrtim që përmban të dhënat e përkthyesit ose interpretit të gjuhës së shenjave dhe parashtimet e tij, parashtimin e pretenduar të fakteve dhe rrethanave, pretendimet dhe propozimet e ministrit të Drejtësisë dhe bazën ligjore të tyre, çështjet apo rrethana për të cilat komisioni vlerëson se duhet të sqarohen në seancë dëgjimore, propozimin për vendimmarrje në mbledhje, si dhe relaton çështjen në seancë para komisionit disiplinor

b) kryen kërkime të tjera hetimore nëse e konsideron të nevojshme;

c) kryen të gjitha procedurat për të siguruar administrimin e dokumentacionit të nevojshëm dhe të informacionit shtesë për procesin e vendimmarrjes së komisionit disiplinor;

ç) merr masat për të hartuar të gjitha aktet procedurale, deri në përfundimin e procedimit disiplinor

d) koordinon punën me kryetarin për përgatitjen e mbledhjes;

dh) çdo detyrë tjetër sipas këtij urdhri ose që i caktohet nga kryetari.

1. Komisioni mblidhet dhe zhvillon seancën dëgjimore jo më vonë se 10 ditë nga paraqitja e raportit të hetimit së bashku me dosjen hetimore nga ministri i Drejtësisë për procedim disiplinor.

2. Kryetari cakton datën e mbledhjes jo më vonë se 3 ditë nga marrja e raportit të hetimit dhe njofton çdo ndryshim për datën e mbledhjes.

3. Kur nuk plotësohet kuorumi i nevojshëm për mbledhjen, kryetari vendos thirrjen e mbledhjes në një ditë tjetër të afërt. Në rast se subjekti i procedimit disiplinor ose përfaqësuesi ligjor i tij nuk është i pranishëm, vlerëson shkaqet e mosparaqitjes në seancë. Në rast se mosparaqitja ka ndodhur për shkaqe që nuk vlerësohen të arsyeshme, vendos vijimin e seancës pa praninë e subjektit ose përfaqësuesit të tij ligjor. Në rastet kur vlerësohet se subjekti i procedimit ka paraqitur shkaqe të arsyeshme apo shkaqe të cilat vlerësohen si të tilla, kryetari shtyn mbledhjen duke kryer një njoftim të dytë për një datë tjetër sa më të afërt. Nëse edhe në këtë datë subjekti i njoftuar rregullisht dhe/ose përfaqësuesi i tij nuk paraqiten para komisionit, vendoset vazhdimi i seancës në mungesë.

Neni 20

Procesverbali i mbledhjes

1. Dokumentimi i të gjithë veprimtarisë së Komisionit gjatë mbledhjes pasqyrohet në procesverbalin e mbledhjes, i cili mbahet nga sekretari që zgjidhet nga radhët e anëtarëve, nën drejtimin dhe mbikëqyrjen e kryetarit dhe përmban:

- a) datën dhe vendin e mbledhjes;
- b) anëtarët që marrin pjesë në mbledhje;
- c) çështjet që u diskutuan në mbledhje;
- ç) vendimet që u morën në mbledhje, argumentet për vendimmarrje, afatet e përcaktuara në vendimmarrje;
- d) dorëheqjet e anëtarëve dhe arsyetimet përkatëse;
- dh) formën e votimit (i hapur ose jo) dhe rezultatin e tij;
- e) rezultatet e votimit, mënyrën e votimit të secilit anëtar dhe arsyetimin e votimit nga secili anëtar.

2. Procesverbali i mbledhjes u paraqitet për miratim të gjithë anëtarëve në fund të mbledhjes ose në fillim të mbledhjes pasardhëse. Pas miratimit, procesverbali nënshkruhet së bashku nga kryetari, sekretari dhe nga anëtari i zgjedhur nga ministri i Drejtësisë, kur ky i fundit nuk është caktuar si sekretar.

3. Mbledhjet e komisionit disiplinor dokumentohen edhe nëpërmjet regjistrimit audio.

4. Një kopje e procesverbalit të mbledhjes, regjistrimi audio, transkriptimi i tij, nëse është e mundur dhe të çdo materiali tjetër të administruar gjatë zhvillimit të saj depozitohet së bashku me vendimin përfundimtar të arsyetuar pranë Ministrisë së Drejtësisë.

Neni 21

Detyrimi për të marrë pjesë në mbledhje

1. Pjesëmarrja e anëtarëve në mbledhjet e Komisionit Disiplinor është e detyrueshme. Në rastet kur një anëtar nuk merr pjesë në tri mbledhje të njëpasnjëshme, pa një shkak të ligjshëm, konsiderohet që ka hequr dorë si anëtar i komisionit disiplinor. Në këtë rast kryetari ose në rastin kur kryetari nuk merr pjesë në tri mbledhje të njëpasnjëshme, anëtari i zgjedhur nga ministri i Drejtësisë njofton menjëherë organin e emërtesës dhe Ministrinë e Drejtësisë për zëvendësimin e tij.

2. Procedura për zgjedhjen e anëtarit të ri të komisionit disiplinor fillon jo më vonë se 15 ditë nga data e marrjes së njoftimit.

Neni 22
Përgatitja e vendimeve

1. Arsyetimi dhe zbardhja e plotë e vendimeve që merr komisioni disiplinor bëhet nga relatori jo më vonë se 2 (dy) ditë nga data e përfundimit të seancës dëgjimore, sipas arsyetimit të shumicës së anëtarëve që kanë votuar pro vendimit.

2. Nëse pas votimit të vendimit, relatori është në pakicë, kryetari i komisionit, cakton një anëtar tjetër nga shumica për të arsyetuar vendimin përfundimtar. Mendimi paralel dhe mendimi i pakicës hartohet nga anëtari përkatës dhe i dorëzohet anëtarit që arsyeton dhe zbardh vendimet menjëherë dhe i bashkëngjitet vendimit.

3. Anëtarët e komisionit disiplinor shqyrtojnë dhe miratojnë me anë të nënshkrimit versionin përfundimtar të vendimit.

Neni 23
Marrja e vendimeve nga Komisioni

1. Komisioni disiplinor merr vendim në lidhje me angazhimin e ekspertëve dhe përcaktimin e detyrave të tyre, shtyrjen e seancave, pranueshmërinë e provave, zgjidhjen e çështjes, si dhe çdo çështje tjetër që e vlerëson të nevojshme ose të përshtatshme në trajtimin e çështjes.

2. Komisioni merr vendime vetëm për çështje të cilat janë përfshirë në rendin e ditës së mbledhjes.

3. Marrja e vendimeve në mbledhjen e komisionit bëhet me votim, i cili është individual dhe i hapur.

4. Përjashtimisht, votimet që kanë të bëjnë me etikën, cilësitë ose sjelljet e subjektit të procedimit disiplinor merren me votim të fshehtë.

5. Secili prej anëtarëve ka të drejtën e ushtrimit të një vote. Në asnjë rast, e drejta e votës nuk mund t'i delegohet ndonjë anëtar tjetër të Komisionit.

6. Vendimet e Komisionit Disiplinor miratohen me shumicën e të gjithë anëtarëve të Komisionit, si dhe arsyetohen në mënyrë të plotë.

7. Anëtari në pakicë mund të kërkojë që të shënohet në procesverbal fakti dhe arsytet e votimit kundër një vendimi të marrë nga Komisioni.

8. Votat e anëtarëve të Komisionit Disiplinor regjistrohen në procesverbalin e mbledhjes.

KREU IV
ZHVILLIMI I PROCEDIMIT DISIPLINOR

Neni 24
Nisja e procedimit disiplinor

1. Komisioni nis shqyrtimin e procedimit disiplinor pas administrimit të raportit e hetimit së bashku me dosjen hetimore të përcjellë nga ministri i Drejtësisë.

2. Procedimi disiplinor vazhdon edhe në rast se pala në proces tërheq ankimin dhe gjatë verifikimit janë konstatuar shkelje të detyrës apo veprime të parregullta, të kryera gjatë ushtrimit të profesionit.

3. Relatori verifikon nëse raporti i hetimit dhe dosja hetimore plotësojnë kriteret formale.

4. Kur vlerësohet se janë plotësuar kriteret formale, relatori i propozon komisionit disiplinor mbylljen e procedimit disiplinor pa seancë dëgjimore sipas rasteve të përcaktuar në këtë urdhër ose caktimin e seancës dëgjimore.

Neni 25

Njoftimi i përkthyesit zyrtar ose interpretit të gjuhës së shenjave

1. Përkthyesi zyrtar ose interpreti të gjuhës së shenjave njoftohet të paktën 10 ditë përpara zhvillimit të seancës në lidhje me datën, orën dhe vendin e zhvillimit.

2. Subjekti i procedimit njoftohet në lidhje me të drejtën:

a) për të paraqitur shpjegime me shkrim për ankesën brenda 10 (dhjetë) ditëve nga dita e marrjes së njoftimit;

b) për të marrë pjesë në seancë dëgjimore dhe për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur;

c) për të thirrur dëshmitarë që mund të dëshmojnë fakte me interes për çështjen;

ç) për të paraqitur dokumente;

d) për të marrë masa të tjera për paraqitjen e provave në mbështetje të mbrojtjes së tij;

dh) për t'u përfaqësuar, sipas parashikimeve të Kodit të Procedurave Administrative.

3. Komisioni mund t'i kërkojë përkthyesit zyrtar ose interpretit të gjuhës së shenjave të paraqesë të dhëna, dokumente ose çdo lloj prove, si dhe të marrë pjesë në seancë dëgjimore.

4. Njoftimi i subjektit për të cilin është vendosur fillimi i procedimit disiplinor dhe njoftimi i akteve të komisionit disiplinor bëhet:

a) personalisht ose përfaqësuesit ligjor kur janë të pranishëm në çastin e shpalljes së aktit;

b) nëpërmjet postës elektronike përkthyesit zyrtar ose interpretit të gjuhës së shenjave apo në rrugë postare në adresat e deklaruara në regjistrin elektronik të përkthyesve zyrtarë dhe interpretëve të gjuhëve të shenjave.

Neni 26

Të drejtat e përkthyesit zyrtar dhe interpretit të gjuhës së shenjave

1. Gjatë procedimit disiplinor, përkthyesi zyrtar, interpreti i gjuhës së shenjave ose përfaqësuesi i tij ka të drejtë të njihet me dokumentet e dosjes dhe të marrë kopje të tyre. Brenda pesë ditëve nga paraqitja e kërkesës, komisioni i siguron atij kushtet për njohjen me dosjen dhe i vë në dispozicion kopje të dokumenteve.

2. E drejta e aksesit me dosjen mund të kufizohet vetëm nëse është e domosdoshme, proporcionale dhe nëse dhënia e informacionit shkakton një dëm të rëndë dhe të pariparueshëm ndaj interesave të mëposhtëm:

a) të drejtave themelore të një personi tjetër;

b) funksionimin e komisionit disiplinor;

c) qëllimin e procedimit.

3. E drejta e aksesit kufizohet për atë kohë sa ekzistojnë shkaqet e mësipërme. Në çdo rast, përkthyesi zyrtar, interpreti i gjuhës së shenjave ose përfaqësuesi i tij ka akses në dosje para se komisioni të marrë vendimin.

Neni 27

Mbyllja e procedimit disiplinor pa seancë dëgjimore

1. Komisioni vendos mbylljen e procedimit disiplinor pa zhvilluar seancë dëgjimore nëse:

a) shkelja disiplinore është parashkruar në kohën kur ka filluar hetimi;

- b) çështja ka qenë objekt i procedimit disiplinor që është zgjidhur me vendim të formës së prerë;
 - c) raporti i hetimit është depozituar pa u arsyetuar;
 - ç) përkthyesi zyrtar ose interpreti i gjuhës së shenjave ka ndërruar jetë.
2. Heqja dorë nga ushtrimi i profesionit nuk ndalon fillimin ose vazhdimin e procedimit disiplinor.
3. Komisioni mbyll procedimin disiplinor, sipas parashikimeve të këtij neni, me vendim të arsyetuar me shkrim dhe njofton palët për shkaqet e mbylljes.

Neni 28

Bashkimi i procedimeve disiplinore

Kur komisioni konstaton që procedimi disiplinor u referohet të njëjtave fakte dhe të njëjtit përkthyes zyrtar ose interpret të gjuhës së shenjave, mund të vendosë bashkimin e procedimeve.

Neni 29

Seanca dëgjimore

1. Seanca dëgjimore për procedimet disiplinore është publike.
2. Komisioni disiplinor, kryesisht ose me kërkesë të palëve, mund të vendosë zhvillimin e seancës me dyer të mbyllura, në rastet kur:
 - a) publiciteti i seancës mund të dëmtojë moralin e shoqërisë ose mund të bëjë publike të dhëna sekrete që cenojnë sigurinë kombëtare, nëse kjo kërkohet nga autoritetet kompetente;
 - b) është e nevojshme të mbrohet e drejta e jetës private, sekreti tregtar, apo të dhënat personale të përkthyesit zyrtar ose interpretit të gjuhës së shenjave apo të një personi tjetër;
 - c) nga publiku kryhen veprime që prishin zhvillimin normal të seancës dëgjimore.
3. Në seancë dëgjimore para komisionit disiplinor:
 - a) ministri i Drejtësisë ose përfaqësuesi i tij paraqet argumentet që shkelja disiplinore është kryer dhe propozon masën disiplinore që duhet të merret;
 - b) përkthyesi zyrtar ose interpreti i gjuhës së shenjave, ose edhe përfaqësuesi i tij, paraqet argumentet mbrojtëse.
 - c) relatori i çështjes bën referimin e fakteve, analizën e bazës ligjore dhe të qëndrimeve të palëve të përcaktuar më sipër dhe propozimet konkrete mbi vijueshmërinë e çështjes.
4. Përmbajtja e parashkrimeve me shkrim nuk përsëritet gjatë seancës dëgjimore.
5. Komisioni disiplinor mund të shtyjë seancën për një periudhë prej jo më shumë se 7 ditësh, kur konsideron të nevojshme marrjen e provave shtesë.

Neni 30

Solemniteti i seancës

1. Gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore respektohen rregullat e solemnitetit, të cilat janë:
 - a) respektimi i orarit të caktuar për zhvillimin e seancës nga pjesëmarrësit;
 - b) respektimin e rendit dhe qetësisë gjatë zhvillimit të seancës;
 - c) respektimin nga palët të kërkesave për të parashtruar në bazë të fakteve të pretenduara shpjegimet e nevojshme e të dobishme për shqyrtimin e çështjes;
 - ç) respektimin e anëtarëve të komisionit dhe të të gjithë pjesëmarrësve të tjerë.
2. Në rast se palët në seancë nuk respektojnë rregullat e solemnitetit, kryetari i komisionit merr masat për zhvillimin e duhur të seancës dhe nëse është e nevojshme, ndërpret diskutimin ose u heq

palëve të drejtën e fjalës, si dhe urdhëron largimin e personave nga sala. 3. Prania e personave të tjerë është e lejuar, për sa kohë nuk pengon zhvillimin normal të seancës.

Neni 31

Zhvillimi i seancës dëgjimore

1. Kryetari, pasi deklaron hapjen e seancës dëgjimore, verifikon kuorumin e nevojshëm për zhvillimin e saj. Nëse ndonjë anëtar i komisionit merr pjesë në mbledhje në distancë, kryetari merr masa për realizimin e këtij komunikimi.

2. Pas hapjes së seancës dëgjimore, kryetari kryen këto veprime procedurale:

a) verifikon legjitimitimin procedural të palëve dhe të përfaqësuesve të tyre, sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Administrative;

b) pyet palët nëse kanë ndonjë kërkesë procedurale, që lidhet me legjitimitimin apo zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor;

c) deklaron të hapur shqyrtimin e procedimit disiplinor;

ç) u bën të njohur palëve që përmbajtja e parashtrimeve me shkrim nuk përsëritet gjatë seancës dëgjimore

d) u jep të drejtën e fjalës sipas radhës:

i. ministrit të Drejtësisë ose përfaqësuesit të tij, i cili paraqet argumentet që shkelja disiplinore është kryer dhe propozon masat disiplinore që duhet të merren;

ii. përkthyesit zyrtar ose interpretit të gjuhës së shenjave apo përfaqësuesit të tij, për të paraqitur argumentet mbrojtëse.

iii. relatorit

iv. secilit prej anëtarëve të Këshillit që ka pyetje për palët, apo rrethana për të sqaruar.

dh) komunikon vendimin e komisionit:

i. për shtyrjen e seancës dëgjimore;

ii. për administrimin e provave, që plotësojnë kushtet e pranueshmërisë, kanë lidhje me objektin e procedimit dhe kanë rëndësi në zgjidhjen e drejtë të çështjes

iii. për thirrjen e ekspertëve dhe caktimin e detyrave;

iv. pezullimin e procedimit disiplinor;

v. çdo vendim tjetër të marrë gjatë seancës dëgjimore;

e) mbyll fazën e shqyrtimit dhe fton palët për pretendimet e fundit;

ë) njofton datën e shpalljes së vendimit të arsyetuar.

Neni 32

Përfundimi i procedimit disiplinor

1. Pas shqyrtimit të të gjitha fakteve dhe provave, komisioni disiplinor vendos:

a) rrëzimin e kërkesës për procedim disiplinor, për shkak se faktet e pretenduara nuk kanë ndodhur ose ato nuk përbëjnë shkelje disiplinore; ose

b) pranimin e kërkesës, marrjen e një ose më shumë masave disiplinore dhe njoftimin e vendimit ministrit, me qëllim nxjerrjen e urdhrit përkatës për zbatimin e masave që vendosen në procedimin disiplinor. Komisioni nuk është i detyruar t'i qëndrojë masës disiplinore të propozuar nga ministri i Drejtësisë.

2. Komisioni disiplinor shqyrton masën disiplinore dhe jep vendim të arsyetuar me shkrim brenda 7 ditëve nga përfundimi i seancës.

3. Vendimi përfundimtar përmban:

a) organin që ka marrë vendimin;

- b) identitetin e subjektit ndaj të cilit është zhvilluar procedimi disiplinor;
- c) datën e miratimit;
- ç) rrethanat e faktit dhe shkelja/shkeljet e pretenduara;
- d) bazën ligjore;
- dh) pjesën arsyetuese;
- e) dispozitivin;
- ë) të drejtën dhe afatet e ankimit;
- f) nënshkrimin e kryetarit dhe sekretarit të Komisionit Disiplinor.

3. Palët kanë të drejtë të njoftohen për çdo vendim të komisionit disiplinor brenda 5 ditëve nga marrja e tij.

4. Vendimi i komisionit bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Ministrisë së Drejtësisë, i shoqëruar me arsyetimin përkatës, pasi redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Neni 33

Nxjerrja e urdhrit të ministrit të Drejtësisë

1. Ministri i Drejtësisë, brenda 2 javëve nga data e paraqitjes së vendimit të komisionit disiplinor dhe materialeve shoqëruese, nxjerr urdhrin për zbatimin e masave që vendosen në procedimin disiplinor, në të cilin parashikohen edhe modalitetet e zbatimit të tij.

2. Urdhri për zbatimin e masës disiplinore jepet i arsyetuar dhe i njoftohet me shkrim subjektit të procedimit, brenda 5 ditëve nga nxjerrja e tij.

Neni 34

Ankimi

1. Kundër vendimit të komisionit disiplinor përkatës për dhënien e masave disiplinore mund të bëhet ankim në gjykatën administrative kompetente brenda 45 (dyzet e pesë) ditëve nga data e njoftimit të vendimit ose urdhrit.

2. Ankimi kundër vendimit të komisionit disiplinor nuk pezullon zbatimin e tij, derisa vendimi gjyqësor për ankimin të marrë formë të prerë.

3. Vendimi i komisionit disiplinor përkatës, pas kalimit të afatit të ankimit, ose kur lihet në fuqi nga gjykata, regjistrohet në regjistrin elektronik.

KREU V

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 35

Strukturat e ngarkuara për zbatim

1. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore e Çështjeve të Drejtësisë në Ministrinë e Drejtësisë dhe komisionet e disiplinore përkatëse për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.

2. Ngarkohet Sektori i Arkiv-Protokollit në Ministrinë e Drejtësisë për marrjen e masave të nevojshme për njoftimin e këtij urdhri.

Neni 36

Hyrja në fuqi

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I DREJTËSISË
Ulsi Manja